

Bonoja GEK Terna 2025

Shteti: Rajonale

Numri i Projektit: 56782

Spektori i Biznesit: Infrastruktura Bashkiake

Tipi i njoftimit: Privat

Kategoria Mjedisore: IESE

Data e Arovimit: 24 Shtator 2025

Statusi: Firmosur

Data e Publikimit në Anglisht: 2 Tetor 2025

Sipas paragrafit 2.6 i Seksionit III të Politikës për Ndarjen e Informacionit, publikimi i kësaj PSD-je është shtyrë në përputhje me paragrafin 1.4.4 të Direktivës për Ndarjen e Informacionit.

Përshkrimi i Projektit

BERZH investoi 50 milionë euro në bonon e pasiguar me afat 7-vjeçar, në vlerë totale 500 milionë euro, i emetuar nga GEK Terna S.A. ("Emetuesi" ose "Kompania") dhe i listuar në Bursën e Athinës ("ASE").

Të ardhurat e përfituara nga bonoja do të përdoren për të financuar aktivitetet e biznesit të grupit të Emetuesit, ndër të tjera, në sektorët e infrastrukturës dhe energjisë, për të mbështetur blerjet, dhe/ose për të rfinancuar borxhin e Emetuesit dhe/ose të filialeve të tij, si dhe për të mbuluar kostot e emetimit të bonos.

Të ardhurat nga pjesëmarrja e BERZH-it do t'i dedikohen prodhimit të energjisë së rinovueshme, sistemeve të ruajtjes së energjisë me bateri, infrastrukturës sociale dhe investimeve në ujë/ujërat e ndotura në Greqi, Rumani, Shqipëri dhe Kosovë ("Projekti").

Objektivat e Projektit

Projekti synon të mbështesë rritjen e Kompanisë në Greqi dhe Evropën Juglindore duke financuar energjinë e rinovueshme, rateen e energjisë, infrastrukturën sociale dhe

investimet në ujë/ujërat e ndotura, ndërkohë që forcon edhe tregun vendas të bonove korporative në Greqi përmes një emetimi të konsiderueshëm në ASE.

Ai do të mbështesë gjithashtu kanalizimin e fondeve drejt investimeve të gjelbra të pranueshme dhe do të promovojë pjesëmarrjen e sektorit privat në projektet e infrastrukturës publike, përfshirë ato të realizuara përmes konçesioneve dhe partneriteteve publiko-private ("PPP"), duke nxitur njëkohësisht politika dhe praktika gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj barazisë gjinore.

Ndikimi në Tranzicion

ETI:63

Projekti është vlerësuar se kontribuon në objektivat e Tranzicionit të Integruar (TI) nën cilësitë Gjithëpërfshirëse dhe Konkurruese. Ndikimi gjithëpërfshirës do të arrihet përmes promovimit të zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe praktikave të mundësive të barabarta, duke përfshirë forcimin e programeve të praktikave profesionale dhe nismave të synuara për të mbështetur përfaqësimin e grave në të gjithë fuqinë punëtore të Kompanisë. Pritet që pjesa e praktikanteve dhe punonjëseve gra në Kompani të rritet. Ndikimi konkurrues do të arrihet duke mbështetur pjesëmarrjen e sektorit privat në PPP-të në Greqi dhe më gjerë, duke përfshirë potencialisht nënprojektet e përgatitura në kuadër të Mekanizmit të Përgatitjes së PPP-ve në Greqi, të mbështetur nga BERZH ("GPPF").-projektet

Informacioni Për Klientin

GEK TARNA SA

GEK Terna S.A. është një grup udhëheqës në fushën e infrastrukturës, i themeluar në Greqi, dhe aktiv në konçesione, energji dhe ndërtim. Kompania është e listuar në Bursën e Athinës (ASE).

BERZH Përmbledhja Financiare

EUR 50,000,000

Kosto Totale e Projektit

EUR 500,000,000

Vlera e Shtuar

Vlera e shtuar e Bankës buron nga: (i) investimi i Bankës, i cili lehtëson një proces të suksesshëm të ndërtimit të librit të porosive dhe mbështet Emetuesin në realizimin e një emetimi të konsiderueshëm në ASE; (ii) vendosja e standardeve, pasi angazhimi i BERZH-it do të sigurojë që Projekti të zbatohet në përputhje me praktikën më të mirë mjedisore ndërkombëtare; dhe (iii) angazhimi institucional i Kompanisë për të forcuar praktikën e mundësive të barabarta.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategorizuar si B (sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale 2024 (“ESP”)). Projekti është një transaksion në tregjet e kapitalit dhe verifikimi mjedisor e social i Bankës (“ESDD”) është kufizuar në shqyrtimin e dokumenteve të disponueshme publikisht, rishikimin e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (“ESMS”) të Kompanisë kundrejt Kërkesave Mjedisore dhe Sociale (“ESRs”), si dhe raportimin e progresit në kuadër të ESAP-it të bonove të mëparshme (pjesëmarrja e BERZH-it në projektin e bonos GEK Terna SLB 2021).

Niveli i informacionit të disponueshëm dhe verifikimi mjedisor e social (ESDD) ka mundësuar një vlerësim të përshtatshëm të risqeve në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës 2024 (ESP) për këtë Projekt, pasi përdorimi i fondeve të BERZH-it do të kufizohet vetëm në nën-projektet e energjisë së rinovueshme, ruajtjes së energjisë, infrastrukturës sociale, ujit dhe ujërave të ndotura, duke përjashtuar projektet e Kategorisë A. ESDD-ja arriti në përfundimin se Kompania ka kapacitete institucionale të mjaftueshme për të zbatuar Kërkesat Mjedisore dhe Sociale të Bankës (ESRs) brenda projektit të saj. Në përgjithësi, GEK Terna ka një historik të mirë të përputhshmërisë, progres të kënaqshëm në kuadër të ESAP-it të projektit ekzistues dhe së fundmi ka përmirësuar sistemet e saj të menaxhimit mjedisor, shëndetit dhe sigurisë (“EHS”), duke përfshirë edhe kryerjen e analizave të skenarëve të riskut klimatik. Ajo ka publikuar gjithashtu Raportin e Qëndrueshmërisë së Grupit për vitin 2024, i cili është i përafërt me kërkesat e Direktivës për Raportimin e Qëndrueshmërisë së Korporatave (“CSRD”). Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social i integruar i Kompanisë bazohet në një kuadër të gjerë politikash, me ekipe të dedikuara për zbatimin e tij.

Në nivelin e projektit, Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social operacionalizohet përmes procedurave të vendosura, duke përfshirë shqyrtimin fillestar të riskut mjedisor e social (E&S), në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, standardet ndërkombëtare dhe praktikën referente të sektorit. ESDD-ja e bazuar në risk përfshin vizita në terren, konsultime me palët e interesuara (kur është e përshtatshme) dhe analiza të detajuara të ndikimeve të mundshme mbi biodiversitetin, përdorimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore, kushtet e punës, shëndetin dhe sigurinë (“H&S”), si dhe komunitetet përreth,

si edhe integrimin e masave zbutëse në Planet e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (“ESMPs”) dhe procedurat shoqëruese.

Zbatimi i masave zbutëse monitorohet përmes auditimeve të brendshme, raportimeve të rregullta dhe një procesi vjetor rishikimi që përfshin menaxhmentin e lartë dhe ushqen ciklin e përmirësimit të vazhdueshëm të Grupit. Programet e trajnimit korporativ shtrihen edhe te ekipet e nën-projekteve dhe kontraktorët, duke siguruar ndërgjegjësim të gjerë dhe aftësi të nevojshme për menaxhimin E&S. Treguesit e performancës E&S monitorohen rregullisht në nivel projekti. Angazhimi me palët e interesuara është i formalizuar dhe i vazhdueshëm si në nivel korporate, ashtu edhe në nivel projekti, dhe ekziston një mekanizëm korporativ i ankesave për palët e jashtme, me mundësi raportimi në mënyrë anonime. Proceset e shqyrtimit të riskut dhe të verifikimit të kujdesshëm duhet të përditësohen për të siguruar integrimin e plotë të ndryshimeve të fundit të ESP-së në aspektet sociale (ESR1, 5 dhe 8) dhe biodiversitetit (ESR6), si dhe zbatimin e vlerësimeve dhe masave zbutëse në projektet që do të financohen nga fondet e investimit të BERZH-it.

Sistemi i menaxhimit të zinxhirit të furnizimit përfshin një politikë prokurimi, e cila ndër të tjera kërkon respektimin e politikave gjithëpërfshirëse të Kompanisë për të Drejtat e Njeriut dhe HSE, si dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes; procedura për përzgjedhjen e furnitorëve dhe kontraktorëve; verifikim të kujdesshëm të bazuar në risk dhe monitorim pasues; dispozita kontraktuale për përputhshmëri dhe veprime korrigjuese, përfshirë ndërprerjen e kontratës kur kërkohet, si dhe ngritje kapacitetesh dhe trajnime. Përditësimet e sistemit, veçanërisht ato që lidhen me projektet e energjisë, duke përfshirë shqyrtimin e riskut të furnitorëve, kërkesat për gjurmueshmëri dhe verifikim të detajuar, do të zbatohen për projektet që do të financohen nga fondet e investimit të BERZH-it, me qëllim përputhjen e plotë me ESR1 dhe ESR2.

ESAP-i aktual përfshin, ndër të tjera, forcimin e aspekteve të vlerësimit të riskut në sistemin e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit; procedurat e shqyrtimit, kategorizimit dhe verifikimit të kujdesshëm; zhvillimin e procedurave që sigurojnë një vlerësim të qëndrueshëm dhe sistematik të çështjeve sociale (përfshirë marrjen e tokës / ESR5) në nivel projekti; si dhe përditësime të përgjithshme për të reflektuar ESR-të e reja. Banka do të vazhdojë të monitorojë performancën e Kompanisë përmes raporteve vjetore të përgatitura nga vetë Kompania.

Vlerësimi i përputhshmërisë së projektit me objektivin “e Gjelbër”

Projekti është në përputhje me objektivat e zbutjes së ndryshimeve klimatike të Marrëveshjes së Parisit, pasi përfshihet në listën e përbashkët të MDB-ve për projektet e përafruara, nën kategoritë “Energjia”, “Ndërtesat dhe instalimet publike” dhe “Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura”. Kompania ka vendosur praktika të mjaftueshme klimatike në nivel korporate, të cilat i mundësojnë Bankës të konkludojë se projekti është në

përputhje edhe me objektivat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të Marrëveshjes së Parisit.

100% e financimit të BERZH-it klasifikohet si financim i gjelbër, pasi mbështet aktivitete që synojnë zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe objektiva të tjera mjedisore. Atribuimi është bërë në përputhje me metodologjinë për përcaktimin e financimit të gjelbër në investimet e BERZH-it, si dhe udhëzimet specifike në seksionin mbi financimin e gjelbër për bonot me përdorim të përcaktuar të fondeve për investime të pranueshme të gjelbra.

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi i Granteve

N/A

Informacion Kontakt i Kopmanisë

Alexandros Skordos

askordos@gekterna.com

+30 210 6968000

+30 210 6968099

<http://www.gekterna.com/>

85 Mesogeion Ave, Athinë 11526, Greqi

Përditësimi i Fundit i PSD

2 Tetor 2025

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efektive për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.

